



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:055119

Datë: 21.12.2020

Numri i dokumentit: 01359162

**PKR.nr.245/17**

## NË EMËR TË POPULLIT

**Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda**, duke vendosur sipas kryetarit të trupit gjykues Naser Maliqi, me anëtarët e trupit gjykues Agim Ademi dhe Sabedin Mushica, me zyrtaren Juridike Fikrete Destani, në çështjen penale të të akuzuarve **L. I** nga Gjilani, për shkak të veprave penale : hyrje në sistemet kompjuterike nga neni 339 par.2 lidhur me para.1 të KPRK-se dhe vepres penale nga neni 13 par.3 dhe neni 15 par.1 të Ligjit mbi parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetike, falsifikim i letrave me vlerë dhe instrumenteve të pageses nga neni 293 par.4 lidhur me paragrafin 1 e 2 të KPRK-se, shmangie nga tatimi nga neni 313 par. 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-se, të cilin e mbron Av. Ymer Huruglica nga Gjilani, **L. Sh nga ..., për shkak të veprave penale:** hyrje në sistemet kompjuterike nga neni 339 par.2 lidhur me para.1 të KPRK-se dhe vepres penale nga neni 13 par.3 dhe neni 15 par.1 të Ligjit mbi parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetikë, falsifikim i letrave me vlerë dhe instrumenteve të pageses nga neni 293 par.4 lidhur me paragrafin 1 e 2 të KPRK-se, të cilin e mbron Av. Vebi Ismajli nga Prishtina dhe **L. M** për shkak të veprave penale: hyrje në sistemet kompjuterike nga neni 339 par.2 lidhur me para.1 të KPRK-se dhe vepres penale nga neni 13 par.3 dhe neni 15 par.1 të Ligjit mbi parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetike, falsifikim i letrave me vlerë dhe instrumenteve të pageses nga neni 293 par.4 lidhur me paragrafin 1 e 2 të KPRK-se, të cilin e mbron Av. Selami Rexhepi nga Gjilani, e sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan,

Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.141/2017 e dt.12.12.2017, e pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqesor me dt. 02.11.2020, shpallë, ndersa me date 15.12.2020 përpilon:

## **AKTGJYKIM**

### **I akuzuari;**

**L I**, nga babai ... dhe nena ..., e lindur Idrizi, I lindur me ... ku edhe jeton rr. "... " nr. 9, k ate kryer shkollen e mesme, I pa pune, I gjendjes se mesme ekonomike, I pa martuar, shqiptare , shtetats I Republikes Kosoves.

- e ne baze te nenit 363 paragrafi 1 pika 1.2 te KPPRK-se,per shkak te terheqjes se prokurorit nga akuza,

## **REFUZOHET AKUZA**

### **I.**

I pandehuri me qëllim të fshehjes tërsisht nga pagesa e tatimit dhe kontributeve tjera, që kerkohen me ligj, perkundër që në agjensin e regjistrimit të bizneseve të Kosovës me datë 13.12.2011 ka regjistruar biznesin NTSH "... " me nr. biznesi ..., gjatë kësajë periudhe ka patur qarkullim-të hyra dhe ate per vitin 2012 shumën prej **10.144,99 euro**, për vitin 2013 shumën prej **36.784,23 euro** dhe për vitin 2014 shumën prej 26.547,96 euro, të hyrat për këto tri vite kan qen 73.477,18 euro dhe për këtë qarkullim obligime tatimore të shmangura në shumë prej **8.795,35 euro** dhe në këtë mënyrë ka perfituar për vehte, ndërsa i ka shkaktuar dëm Bugjetit të Republikës së Kosovës për shumat e lartëcekura.

-me cka kishte me kryer vepren penale, shmague nga tatami nga neni 313 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 te KPRK-se.

**Shpenzimet** e procedures penale lidhur me kete veper mbesin ne barre te mjeteve buxhetore te KGJK-se.

### **Te akuzuarit;**

**1.L. I** nga babai ... dhe nena ... e lindur Idrizi, I lindur me ..., ku edhe jeton rr. "... " nr. 9, k ate kryer shkollen e mesme, I pa pune, I gjendjes se mesme ekonomike, I pa martuar, shqiptare , shtetats I Republikes Kosoves.

**2.L. Sh** nga babai ... dhe nena ... e lindur D..., I lindur me ... ne ..., ku edhe jeton rr. "... " rr. 8 , k ate kryer shkollen e mesme , I martuar, I pa pune, I

gjendjes se mesme ekonomike, shqiptare, shtetas I Republikes se Kosoves,  
**dhe**

**3.L. M** nga babai ..., dhe nena ..., e lindur ..., I lindur me ..., ne ..., tani me vendbanim ne ..., rr. ... pn. Ka te kryer shkollen e mesme, I pa pune, I gjendjes se varfer ekonomike, shqiptare, shtetas I Republikes se Kosoves.

- e ne baze te nenit 364 paragrafi 1 pika 1.3, nenit 454 paragrafi 1 te KPPRK-se,

#### **LIROHEN NGA AKUZA**

**L. I;**

#### **II.**

**Nuk eshte vertetuar**, se gjatë periudhës kohore 2011 e deri me 04.gusht 2015, i pandehuri përmes nderhyrjeve në sistemet kompjuterike të shfrytzesve të internetit me programe keqëbërse të qasjes në sitemet kompjuterike të huaja nga largsia, i ka kopjuar të dhënat e kartelave bankare, permbajtjen e shiritit magnetic, fjalekalimet dhe në këtë mënyrë keto instrumente të pagesave , si te dhëna të kartelave bankare, në bazë të ekspertizës se ekspertit të inxhinjerisë kompjuterike ka bërë tregti (shitblerje) të kartelave në forume, ka bere tregti të kredencialeve (username/passëord, kredit kartela) në forume te ndryshme si Skype, Chatroulette, Msn, Yahoo messenger, Mail.ru e tj, i njeiti ka pasur disa llogari bankare (per pagesë përmes internetit) siq jan :PayPal,Ebay, Money Gram e tj.

-me cka kishte me kryer veprën penale, falsifikim i letrave me vlerë dhe instrumenteve të pagesës nga neni 293 paragrafi 4 e lidhur me paragrafin 1 e 2 te KPRK-se.

**I akuzuari L. Sh;**

#### **III.**

**Nuk eshte vertetuar**, se gjatë periudhës kohore 2014 e deri më 4. Gusht 2015, i pandehuri përmes ndërhyrjeve në sistemin kompjuterik të shfrytzesve të internetit me programe keqëbërse të qasjes në kompjuterët e huaj nga largsia i ka kopjuar të dhenat e kartelave bankare, përmbajtjen e shiritit magnetic, fjalekalimet dhe në këtë mënyrë këto instrumente të pagesave si të dhënat e kartelave bankare në bazë të ekspertizës së ekspertit të inxhinjerisë kompjuterike, ka bërë shitjen e kredit kartelave

në forume, nga dëshmite e prezentuara (raporti i forenzikes IEF ka pasur disa llogari bankare për pagesa përmes internetit siq janë; Bitcoin, Ebay e tj. . dhe ka bërë tregti (shitje-blerje) të kredencialeve (username/passëord, kreditkartela) të ndryshme në forume të ndryshme si Skype, Yahoo, messenger e tj.

-me cka kishte me kryer veprën penale, falsifikim i letrave me vlerë dhe instrumenteve të pagesës nga neni 293 paragrafi 4 e lidhur me paragrafin 1 e 2 të KPRK-se.

## **I akuzuari L. M**

### **IV.**

Nuk është vertetuar, se gjatë periudhës kohore 2014 e deri më 4. Gusht 2015, i pandehuri përmes ndërhyrjeve në sistemin kompjuterik të shfrytëzuesve të internetit me programe keqëbërse të qasjes në kompjuterët e huaj nga largësia i ka kopjuar të dhënat e kartelave bankare, përmbajtjen e shiritit magnetik, fjalekalimet dhe në këtë mënyrë këto instrumente të pagesave si të dhënat e kartelave bankare në bazë të ekspertizës së ekspertit të inxhinjerisë kompjuterike, ka bërë shitjen e kredit kartelave në forume, nga dëshmite e prezentuara (raporti i forenzikes IEF ka pasur disa llogari bankare për pagesa përmes internetit siq janë; PayPal, Ebay, Fedex, Ëalmart e tj dhe ka bërë tregti (shitblerje) të kredencialeve (username/passëord, kreditkartela) të ndryshme, në forume të ndryshme si Skype, Chatroulette, Msn, Yahoo messenger e tj.

-me cka kishte me kryer veprën penale, falsifikim i letrave me vlerë dhe instrumenteve të pagesës nga neni 293 paragrafi 4 e lidhur me paragrafin 1 e 2 të KPRK-se.

**Shpenzimet** lidhur me këto vepra penale, mbesin në barre të mjeteve bugetore të KGJK-se.

## **Te akuzuarit;**

### **Te akuzuarit;**

**1.L. I** nga babai ... dhe nena ..., e lindur ..., I lindur me ... ku edhe jeton rr. "... " nr. 9, ka kryer shkollën e mesme, I pa punë, I gjendjes së mesme ekonomike, I pa martuar, shqiptarë, shtetats i Republikës Kosovës.

**2.L.Sh** nga babai ... dhe nena ..., e lindur ..., I lindur me ... ne ..., ku edhe jeton rr. "... rr. 8 , k ate kryer shkollen e mesme , I martuar, I pa pune, I gjendjes se mesme ekonomike, shqiptare, shtetas I Republikes se Kosoves, **dhe**

**3.L. M** nga babai ..., dhe nena ..., e lindur ... I lindur me .... ne ..., tani me vendbanim ne .... rr..... poshtem,, rr. ... pn. Ka te kryer shkollen e mesme, I pa pune, I gjendjes se varfer ekonomike, shqiptare, shtetas I Republikes se Kosoves.

**JAN FAJTOR**  
**SEPSE**

**I akuzuari L. I;**

**V.**

**Nga viti 2011** e deri më 4 gusht 2015, i pandehuri me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, dhe me qëllim që t'i shkakttoi dëm personave të tjerë, ka ndërhy në menyrë të paautorizuar në sistemet kompjuterike të shfrytzuesve të internetit kryesisht në SHBA përmes kompanisë YAHOO, duke kopjuar, vjedhur të dhëna të ndjeshme si të dhënat për llogari bankare dhe këto të dhëna i ka arhivuar në një server të veqant, ashtu që ka përdorë web faqen e **krijuar** për shitjen e programeve të ndryshme për infektimin me virus të kompjuterve SHELL (virus për vjedhjen dhe mundsinë e qasjes në kompjuter), SPAM (virus për vjedhjen e të dhënave kompjuterike), shitjen e softverve dhe të dhënave bankare, ashtu që në web faqen [ëëë.toolsh0p.bz](http://ëëë.toolsh0p.bz), **të cilën e ka krijuar dhe e ka menagjuar i pandehuri**, e në të cilat i ka te dhënat i pandehuri si nr. i telefonit mobil, adresa e shtëpisë si dhe disa email adresa, i ka shitur te personat e tjerë dhe për shitjen e programeve keqebërse ka pranuar pagesa nga shtetas të shteteve të ndryshme si Kina, Amerika, Rusia, Ukraina e tj., permes Wester Union Money Gram, duke përfituar shumë prej **73.477,18** euro, duke pranuar në emerit e tij dhe anetarve te ngushtë të familjes.

**-Me cka ka kryer veprën penale**, hyrje në sistemet kompjuterike nga neni 339 par.2 lidhur me para.1 te KPRK-së dhe veprës penale nga neni 13 par.3 dhe neni 15 par.1 te Ligjit mbi parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetike, falsifikim i letrave me vlere.

**I akuzuari L.Sh**

## VI.

Nga viti 2014 e deri me 4 gusht 2015, i pandehuri me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, dhe me qëllim që t'i shkaktoi dëm personave të tjerë, ka nderhy në mënyrë të paautorizuar në sistemet kompjuterike dhe ka përdorë programe të ndryshme dhe ka arritur qasje në sistemet kompjuterike, serverët e shtetasve të huaj dhe nga aty ka arritur të vjedhë informata të kredit-kartelave dhe më pastaj këto informata i ka qfaqur në një ankand online përmes mesengerit të YAHOO-se, disa nga këto i ka tërhequr në Zvicërr përmes Halit Kadriut, ku në paisjet elektronike të sekuestruara nga i pandehuri në bazë të ekspertizës të ekspertit të Inxhinierisë kompjuterike, janë gjetur kredenciale-miliona emaila nga e mbar bota SHBA, Gjermani, Britani e madhe, Australi e tj, së bashku me fjalekalimet, gjë që mundsojnë qasje në këto emaila pa lejen e pronarit, po ashtu në keta folldera janë me mijra kredenciale (IP adresa, Username dhe passëord) për qasje në largsi të kompjuterive-serverve të ndryshëm me adresa fizike-gjeografike kryesisht në SHBA, ku si të dëmtuar paraqiten të gjitha palët që janë listuar përmes IP adresës, bizneset që kanë pasur të hostuar shërbimet e tyre në server dhe personat fizik-qytetar me emër dhe mbiemër, kredit-kartelat e të cilve janë listuar në këto fajlla.

**-Me cka ka kryer veprën penale,** hyrje në sistemet kompjuterike nga neni 339 par.2 lidhur me para.1 të KPRK-se dhe veprës penale nga neni 13 par.3 dhe neni 15 par.1 të Ligjit mbi parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetike, falsifikim i letrave me vlerë.

**I akuzuari L. M;**

## VII.

Nga viti 2014 e deri me 4 gusht 2015, i pandehuri me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, dhe me qëllim që t'i shkaktoi dëm personave të tjerë, ka nderhy në mënyrë të paautorizuar në sistemet kompjuterike dhe ka përdorë programe të ndryshme dhe ka arritur qasje në sistemet kompjuterike, serverët e shtetasve të huaj dhe nga aty ka arritur të vjedhë informata të kredit-kartelave dhe më pastaj këto informata i ka shfaqur në një ankand online përmes mesengerit të YAHOO-se, në baze të ekspertizës të ekspertit të inxhinjerisë kompjuterike, janë gjetur folder "Doënlaads që përmban mbi 49 fajlla (dokumente) të cilat në total janë afër 10.000 kredenciale (IP adresa, username dhe passëord) për qasje në largsi të kompjuterive (serverve të ndryshëm) me adresa fizike (gjeografike) kryesisht në SHBA. Vetëm fajlli "Spamtool-shop-accounts.sql" ka 5.286

kredenciale. Me keto kredenciale mundsohet qasja e pa penguar ne keta server. Veglat (Tools) te gjetura ne kete folder Doënloads) perdoren per qasje ne largsi (FileZilla) dhe kryerjen e pagesave perms internetit (Bitcoin), ku sit e demtuar paraqiten te gjitha palet qe jan listuar perms IP adreses, bizneste qe kan pasur te hostuar sherbimet e tyre ne server dhe personat fizik-qytetar me emer dhe mbiemer, kreditkartelat e te cilve jan te listuara ne keta fajlla.

**-Me cka ka kryer veprën penale, hyrje në sistemet kompjuterike nga neni 339 par.2 lidhur me para.1 te KPRK-se dhe veprës penale nga neni 13 par.3 dhe neni 15 par.1 te Ligjit mbi parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetike, falsifikim i letrave me vlere.**

-Andaj ne baze te nenit 4,38, 40,42,43,69,70,71,72, te KPRK-se dhe neneve 364 dhe 450 te KPPRK-se,

## **I GJYKON**

**1.Te akuzuarin L. I me denim me gjobe ne lartsi prej 5.000,00 (pesemije) euro dhe me denim me burg ne kohezgjatje prej 3 (tre) vite e 6 (gjashte) muaj burg, ne te cilin denim do t'I llogaritet edhe koha e qendrimit ne paraburgim prej 04.08.2015 deri me 30.11.2015, e te cilat denime do te egzekutohen pas kalimit te aftit prej 15 ditesh nga dita e plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi.**

**2.Te akuzuarin L. Sh me denim me gjobe ne lartsi prej 3.000,00 (tremije) euro dhe denim me burg ne koghezgjatje prej 3 (tri) vite, ne te cilin denim me burg do t'I llogaritet edhe koha e qendrimit ne paraburgim prej 04.08.2015 deri me 30.11.2015, te cilat denime do te egzekutohen pas kalimit te aftit prej 15 ditesh nga dita e plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi.**

**3. Te akuzuarin L. M me denim me gjobe ne lartsi prej 3.000,00 (tremije) euro dhe denim me burg ne koghezgjatje prej 3 (tri) vite, ne te cilin denim me burg do t'I llogaritet edhe koha e qendrimit ne paraburgim prej 04.08.215 deri me 30.11.2015, te cilat denime do te egzekutohen pas kalimit te aftit prej 15 ditesh nga dita e plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi.**

**Detyrohen** te akuzuarit L. I L. Sh dhe L.M qe sejcili prej tyre, ne emer te paushallit gjyqsor te paguajn nga 200 (dyqind) euro, dhe nga 50 euro sejcili prej tyre per viktimat e krimit, ndersa shpenzimet e procedures sipas llogarise perfundimtare.

**Te akuzuarit L. I I** konfiskohen: një lllaptop HP ..., një kompjuter HP Compaq ..., Kompjuter LG..., Laptop Lenova ... CD Princo, Iphone 6 ngjyre ari ..., Samsung ngjyre hiri ... Kartele Bankare E. P RaiffaisenBank, Kartel Bankare L.I Payoneer, Laptop HP ..., Laptop Asus ..., Laptop Samsung ...

**Te akuzuarit L. M I** konfiskohen: CD te ndryshme pa mbishkrim, SD Karten, kartela bankare ....te cilat do te shkatrrohen pas plotfuqishmeris se ketij aktgjykimi.

**Te akuzuarit L. I I** konfiskohen 2 banknota nga 100 euro, 16 banknota nga 50 euro, ne shume te pergjithshme prej 1.000,00 (njimije)Euro dhe te pandehurit **L. Sh I konfiskohet shuma e parave** prej 4.500,00 (katermijeepesqind) euro, te cilat pas plotfuqishmeris se ketij aktgjykimi do te derdhen ne Bugjetin e Republikes se Kosoves.

**Te akuzuarit L. Sh i** konfiskohen;  
Dy DVD,  
Një USB-SSK 16 GB me numër serik ...,  
Dy USB- Verbotim ngjyrë e zezë,  
Një USB - Sony 16 GB - ngjyrë e bardhë,  
Një w USB - Sony 16 GB - ngjyrë e zezë  
Një USB - Adata c 906 ngjyrë e zezë,  
Një telefon Samsung SM....  
Një telefon Samsung ...  
Një telefon Iphone..,  
Një laptop lenovo - Type ..., Product ... 11. Një laptop lenovo - ... - 8 EI S/N R..., Product, ...,  
Një Adapter i hardiskit të jashtëm,  
Një tel Nokis sn. ...  
Një tel.Soni Ericson ngjyrë hiri, te cilat do te asgjesohen pas plotfuqishmeris se ketij aktgjykimi.

**Te pandehurit L. II kthehet vetura Audi** me targa ... me nr. identifikues ... qelsat dhe gjithe dokumentacioni percjells I vetures.



## ARSYETIM

**Prokuroria Themelore ne Gjilan**, me dt. 12.12.2017, ka ngritur aktakuzën PP.nr.141/2015 , ndaj të akuzuarve **L. I** nga ...i, për shkak të veprave penale : hyrje në sistemet kompjuterike nga neni 339 par.2 lidhur me para.1 te KPRK-se dhe veprës penale nga neni 13 par.3 dhe neni 15 par.1 te Ligjit mbi parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetike, falsifikim i letrave me vlerë dhe instrumenteve të pagesës nga neni 293 par.4 lidhur me paragrafin 1 e 2 te KPRK-se, shmangie nga tatimi nga neni 313 par. 3 lidhur me paragrafin 1 te KPRK-se, **L. Sh nga ..., per shkak te veprave penale:** hyrje ne sistemet kompjuterike nga neni 339 par.2 lidhur me para.1 te KPRK-se dhe veprës penale nga neni 13 par.3 dhe neni 15 par.1 te Ligjit mbi parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetike, falsifikim i letrave me vlerë dhe instrumenteve të pagesës nga neni 293 par.4 lidhur me paragrafin 1 e 2 te KPRK-se dhe **L. M** për shkak të veprave penale: hyrje ne sistemet kompjuterike nga neni 339 par.2 lidhur me para.1 te KPRK-se dhe veprës penale nga neni 13 par.3 dhe neni 15 par.1 te Ligjit mbi parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetike, falsifikim i letrave me vlerë dhe instrumenteve te pageses nga neni 293 par.4 lidhur me paragrafin 1 e 2 te KPRK-shë, **dhe** ka kërkuar që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, i njejtë të shpallet fajtor dhe të denohet me denim meritor sipas ligjit.

Ne seancën gjyqësore t[ mbajtur me datë 23.10.2020, gjykata ka marrë aktvendim me te cilin séanca e shqyrtimit gjyqësor te filloi nga e para , sepse nga séancë e kaluar kan kaluar me teper se tre muaj.

Prokurori I shtetit në fjalën perfundimtare të mbajtur në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 27.11.2020 e ka tërheq akuzën ndaj te akuzuarit L.I për shkak të veprës penale shmangie nga tatimi nga neni 313 par.3 e lidhur me par. 1 te KPRK-se, për këtë arsye gjykata e ka refuzuar akuzën, si në dispozitivin e I. te ketij aktgjykimi.

Te akzuarit në asnjë fazë të procedurës nuk e kan pranuar fajsinë për veprat penale të cilat u vihen në barrë.

Duke marrë parasysh, se séanca e shqyrtimit gjyqësor kishte filluar nga e para, gjykata ka marre aktvendim që të lexohen dëshmia e Ekspertit Blerim Rexha të dhënë në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës

25.09.2018, dëshminë e dëshmitarit I. I e dhënë në procesverbalin e shqyrtimit gjyqsor të datës 24.12.2018 dhe dëshminë e dëshmitarit Visar Pacolli e dhënë në procesverbalin e shqyrtimit gjyqsor të datës 14.06.2019.

### **Procedura e provave;**

Eksperti i inxhinjeris kompjuterike B. R i cili edhe e ka hartuar ekspertizen lidhur me këtë rast, i njejt i ka deklaruar, se në provat që i janë dorzuar nga ana e Prokurorisë, janë gjetur shënime të ashtuquajtura Kredenciale, të cilat nuk janë të zakonshme të qytetarëve të rëndomtë gjatë përdorimit të internetit. Këto janë të ashtuquajtura username, password dhe IP adresa. Posedimi i këtyre paraqet mundësi për keqpërdorime nga ana e poseduesve, nuk beson se janë përdorë të gjitha sepse është e pamundur të përdorën të gjitha.

Në Harddiskun që i është dorzuar, ka gjetur evidence të forumeve dhe shitblerje të ndryshme, që u takon pronarëve të atij disku. **Te akzuarit nuk e kanë krijuar këto shitore për shitblerje, por kanë qenë një ndër shumë përdoruesit e sajë. Ky ka gjetur në Harddisk se ka pas shitje të atyre kredencialeve, por nuk është konstatuar se a kanë shitur këto kredenciale apo dikush tjetër.**

Në harddisk ka pas shënime për kredit kartela dhe atë me mijë, në sejcilin folder që i është dorzuar. **Me këto shënime që janë gjetur është e mjaftueshme me bërë një pagesë në shumicën e tyre,** sepse disa kartela kanë qenë me afat të skaduar. Marrja e këtyre shënimeve për kredit kartela është e ndryshme, por një shembull mundë të jetë, se një blerje që bëhet në internet dhe nëse nuk ndërrohen shenimet nga shitsi, sepse ai i din shenimet se duhet ta realizoi përmes bankës dhe nëse ai nuk i mbron, **mundë të vie deri të keqepërdorimi,** respektivisht marrja e shenimeve nga kredit kartela. Kredencialet janë mallrat me të kerkuara në internet. Është e ligjshme të ruhen shenimet personale të individit, e jo mijra kredenciale të huaja.

Në raportin me shkrim në faqën e 5-të, pausi i parë, është thënë se të tre të akzuarit kanë bërë tregti me kredenciale.

Kredencialet e kredit kartelave janë përdorë nga të tre të akzuarit, me të dhënat që kanë poseduar, mundesh me ble mall.

Në bazë të mesazheve që ka gjetur nga të akzuarit janë zhvilluar biseda që kanë zhvillu të akzuarit me shitsit gjegjësisht blesit e këtyre kredencialeve. Në bazë të evidencës që ka gjetur në provat e diskut, pagesa e tani të akzuarëve është bërë prej PAY Ball, Money Gram e tj.

Këto keqëperdorime vrehen nga pronart e kredit kartelave, sepse ata jan në Amerike, ndërsa behet një pagesë në Europe. Te demtuar ne kete rast jan pronarët e vërtet të kredit kartelave.

Nga të akzuarit asnjë sistem kompjuterik në Kosove nuk është prekur. Palët e dëmtuara që jan prek nga të gjithë të akzuarit jan nga SHBA, Kanada, Angli e tj.

Ky (eksperti) konstaton se L. I ka nderhy ne sistemet e tjera kompjuterike te shteteve qe i ceku.

Ne bazë te shenimeve që jan gjete në harddisk dhe ne raportin e ekpertit, **që të tre të akzuarit kan bere shitblerje ne internet dhe per habi ka has vetem ne shifra të vogla dhe dhjetra euro dhe rralle me qindar euro.**

Këto pagesa jan bërë nga kreditkartela të huaja. Eksperti ka pranuar qe ne faqen e 5-të pasusi i 2.2 ku flitet për Liridon Isufin, ka përmend se jan gjetur mijra imella dhe po qe se do të ishin shkruar me emer dhe mbiemra, raporti do te kishte dal rreth 300 faqe. **Në përmbajtje ne Harddisk jan ata emra.**

Nga Kosova nuk ka palë të dëmtuar.

**Tetdhjetë mijë shenime me emër dhe mbiemër jan gjetur ne follderin e L.Sh**

Teknikisht ka mundsi që kreditkartelat-shenimet nga këto kartela të huaja të futen në sistemin kompjuterik, duke shkarkuar ndonjë faqe apo virus. Ne follderin e L. Sh ka gjete miliona imella. Nga follderit që është në emër të L. Sh ka ardhur në perfundim se pagesat jan bërë nga shenimet që jan marrë nga follderit.

Edhe per Lavdimin e ka marre harddiskin, ka qen nje folder i ndarë e cekur sakt ne raportin e tij (ekspertit) ne faqe 4-te.

Nuk ka qen kerkese e Prokurorit qe te caktoi sakt demte e shkaktuara.

**Dëshmitari M. I** e ka shfrytzuar të drejtën e tij si deshmitar i privilegjuar, duke theksuar se nuk dëshiron të deshmoi në këtë rast penal, për shkak të afërsisë me të akzuarin Liridon Isufi të cilin e ka djal.

**Deshmitari I. I** ka theksuar per këtë rast ka dhënë deklaratë në polici, por se disa jan të vërteta, por disa nuk jan të verteta, për shkak se ka pas stress me rastin e intervistimit.

E ka pranuar se me L... kan qen njëherë në Prishtinë për të pirë kafe. E pranon se të nesërmën, por saktisht nuk i kujtohet ka tërhequr të holla në Western Union 2 here, por se nuk i kujtohet shuma. Paratë i ka tërhequr ky vet, sepse paratë kan qen në emrin e tij. Parta nuk kan qen të tijat por të L..., por se kan ardhur në emrin e tij. Ato te holla I'a ka

**dhene menjehere L...Nuk i kujtohet sakte, por se L... i ka dhënë dicka prej këtyre parave, pasi që nënën e ka pas të smurë.**

Sa i perket deklaratës se tij të dhënë në polici, se i ka nxjerrë nga Western Union 2.000 euro, nuk e din se a jan të sakta apo jo, sepse kur ka qen ne intervistim në polici ka qen ne gjendje depressive, por që edhe e kan kercnuar hetuesit, duke i thene se të qojna poshtë, e ky ka menduar se po e qojn në burg. Sa i përket shumës së nxjerrë në Gjilan është e sakt, por ajo në Prishtinë nuk e din. Ky nuk e ka pyetur L...se pse paratë jan dërguar në emrin e tij. Nuk e ka pyetur L...se nga kan ardhur këto para, e as ne Western Union nuk e ka kqyrë se nga kan ardhur, por vetëem i ka marre.

**Kodin për terheqjen e parave e ka marre nga L....** Gjate kësajë kohe L... ka punuar You Tube, por nuk e din se si punohet aty.

Dëshmitari nuk e ka pranuar që ka qendruar me Li... një muaj e gjysem në Prishtine, por në polici ka mundur me fol për shkak te presionit apo gjendjes emocionalae.

**Kur ka dalë nga banesa e ka marre lllaptopin me vehte, me qe eshte shume i rendsishem për L...Pas ballafaqimit me kete pjese të deklartës se dhënë në polici e ka pranuar një fakt te tille.**

**L. M e ka parë në banesë atë natë, kur e ka marrë Lllaptopin.**

Nuk e ka pyetur L... se kush i'a ka derguar keto para dhe pse.

**Dëshmitari V.P** ka deklaruar se ka qen hetues ne rastin konkret. Fillimisht informatën e kan pranuar nga FBI për veprën penale që dzshohej se është duke u kryer me nderhyrje në sistemin kompjuterik dhe keqpërdorim të kartelave bankare. Edhe ata kan siguruar disa dëshmi nga Internet servis forëardër ose kompania YAOHO. Nga dëshmitë që ata I kan siguruar vrehet se I dyshuari L. I nga aktivitetet qe I ka ndërmarrë ka ndërhyrje në rrjetin YAOHO. Gjithashtu janë edhe emailat të cilt kan qen në posedim të L.I. Pasi kan filluar hetimin ndaj L. I kan vrejtur se ai nuk vepron I vetëm. Për këtë jan dëshmitë e vëzhgimit dhe transferet bankare që jan siguruar me urdhresë të gjykatës.

Tek transferet që jan siguruat prej kolegve të hetimeve financiare, vrehet se është tërhequr një shumë e parave nga anëtarët e familjes të dyshuarit L. I transferet nga Western Union, gjithashtu edhe nga egzaminimi I tre kompjuterve të të dyshuarve, vrehet se ka të dhëna të kartelave bankare, një numer jashtzakonisht I madhe I tyre.

Gjate bisedave telefonike te dates 25.07.2015 në ora 23;23 min., gjatë bisedës telefonike ndërmjet L. I dhe L. M citoi "do shella i bana hazer kur te vish t'I dha".

Fjala Shell, do të thotë është një virus që infekton një kompjuter duke u mbështjelle rreth kodit, që tash më egziston në kompjuter, siq është kodi I sistemit operativ ose vet Faillat e sistemit operativ I cili shkruhet në një skedar-Fail. Sa herë që programi paraqitet ose sa herë të dhezet psh sistemi operativ kodi egzekutohet ose virusi vepron.

Liridon Isufi në bazë të dëshmive të siguruara nga FBI, ka menagjuar Tull-shop TOOSHOP bizz, kjo ka shërbyer për me shitë të gjitha ato që këta I kan hartuar kompjuterat, të dhënat e kartelave bankare dhe RDP që I permendi më herët.

Në bazë të përgjimeve, L... ka marrë të holla ose të hollat I ka dërguar edhe tek të afërmi I vet H...ne Zvicerr, ai ia ka pranuar të hollat L.Sh e L. I Gjatë kohës kur këta kan ifektuar kumpjuter dhe I kan shitë të dhënat bankare, ato para prej atyre njerzve që jan blerë të dhënat e kartelave bankare, këta kan perfituar prej tyre, për të gjitha këto jan edhe transferet, te cilat jan siguruar prej hetimeve financiare.

Të dhënat e kartelave bankare, të akuzuarit I kan shit shtetasve te ndryshëm, ata jan Kinez, që dëshmohet nga transferet financiare, ku baba I L...shkon tërheqë para në Western Union.

Nëse sigurohen të dhenat e kartelave bankare, mundët edhe me u kry pagesa prej xhirollogaris së huaj.

Toll Shop ka qen I L...ndërsa L... dhe L... kan bashkpunu nëpërmjet Liridonit, sepse keta dy te fundit nuk jan njohur ndermjet veti.

Të dhënat nga FBI jan marre në mënyrë diplomatike.

Lavdim Mjekiqi ka bashpunuar me L. I dhe kjo është vërtetuar në bazë te vëzhgimit, bisedave telefonike dhe keta kan banuar ne një banese.

Bazuar ne pergjimin telefonik te bisedes që permenda ku L... thotë se e lëshova Shellin , është I bindur se është kryer vepra.

Në seancën gjyqsore të date 23.10.2020, Prokurori I shtetit ka hequr dore nga dëgjimi I dëshmitarve H. Kdhe A.B.

Në të njëjtën séancë gjyqsore është refuzuar propozimi I Av. Ymer Huruglica, që gjykata të caktoi një ekspert te Kibernetikes, I cili do te konstatonte se a ka kriju I akuzuari Liridon Isufi [WWW.ToolshOp.bz](http://WWW.ToolshOp.bz), me arsyetim se eksperti B. Rne procesverbalin e datës 25.09.2018, në faqen 7 pasusi I II., rreshti I 15, ndër të tjera ka deklaruar: te akuzuarit nuk e kan

krijuar këtë shitore për shitblerje, por kan qen nji nga shumë përdoruesit e sajë.

### **Leximi I shkresave;**

**-Raporti i ekspertizës** i punuar nga Policia e Kosovës - Drejtoria e Teknikës Kriminalistike e dt. 20 nëntor 2015, ne te cilin jan të konstatuara sendet të cilat jan sekuestruar nga tani të akuzuarit, duke perfshire Laptop, kopjuter, telefona celualar, sim kartela, USB te ndryshem.

**-shikohet fotoalbumi** i punuar nga Policia e Kosovës - Drejtoria e Teknikës Kriminalistike me nr. ... me nr. rastit ... i dt. 13 Nëntor 2015, ku jan percjellë lëvizjet e të pandehurve.

**-Diskun e jashtëm** Power model ... në të cilin janë të kopmujuara të gjitha pisjet elektronike të sekuestruara nga të pandehurit L.I , L.Sh dhe L. M.

**- raporti nga drejtoria** e Teknikës Kriminalistike e dt. 19 dhjetor 2016 për kopimin e të gjitha të dhënave të paisjeve elektronike të të pandehurve në diskun e jashtme LC - Poëer model ... .

**-Procesverbali mbi kontrollin e banesës në emër të L. I** dt. 4 gusht 2015, sipas te cilit procesverbal jan sekuestruar nji lllaptop HP 2000 ..., nji kompjuter HP Compaq ..., Kompjuter LG ... Laptop Lenova .., CD Princo, Iphone 6 ngjyre ari ..., Samsung ngjyre hiri ..., Kartele Bankare E.P RaiffaisenBank, Kartel Bankare L. I 2x nga 100 euro dhe 16x50 euro, Lap Top HP, Laptop Asusdhe Lap Top Samsung.

-procesvebali i pranim dorzimit të automjetit i dt. 4 gusht 2015.

-Procesverbali mbi kontrollin e personit dhe banesës në emër të L. Sh i dt. 4 gusht 2015. Ku janë sekuestruar:

1. Dy DVD,
2. Një USB-SSK 16 GB me numër serik ...
3. Dy USB- Verbotim ngjyrë e zezë,
4. Një USB - Sony 16 GB - ngjyrë e bardhë,
5. Një w USB - Sony 16 GB - njgyrë e zezë
6. Një USB - Adata c 906 ngjyrë e zezë,
7. Një telefon Samsung SM....,

8. Një telefon Samsung DUOS Sh....,
9. Një telefon Iphone S4,
10. Një laptop lenovo - Type ... - ..., Product ID:...,
11. Një laptop lenovo - TYPE... - ...-..., Product, ...,
12. Një Adapter i hardiskit të jashtëm,
13. Një tel Nokis sn. ...,
14. Një tel.Soni Ericson ngjyrë hiri,
16. 6 x 500 €.
17. 2 x 200 €.
18. 4 x 100 €

**-Procesverbali mbi kontrollin** e personit dhe banesës në emër të L. M i dt. 4 gusht 2015, sipas te cilit jan sekuestruar Pasaporta e Kosoves ..., 9 CD te ndryshme pa mbishkrime, 6 dokumenta te ndryshme bankare, 1 SD kartele ... dhe nji kartele bankare ....

**-Raporti nga banka Pro Credit Benk** i dt. 19 maj 2015 për M.I , V. A, A. M dhe Sh. K sipas te ciles H. Inuk ka llogari ne ProCredit Bank.

**-Raporti i bankës NLB Prishtina** i dt. 13 shkurt 2015 për llogarit bankare të të pandehurit L. I, ku eshte perfshi koha e hapjes se llogarise, kontrata e shenime te tjera.

**-Raporti i bankës NLB Prishtin** i dt. 4 maj 2015 për llogarit bankare të M. I A. M dhe H. I.

**-Raporti i Bankës Ekonomike** i dt. 4 maj 2015 lidhur me llogarin bankare të M. I dhe A. M.

Sipas ketij raporti M.I babai i te akuzuarit L. I ka terhequr ne kete banke prej dates 01.11.2013 e deri me 10.02.2014 shumen prej 25,348.49 euro, te cilat te holla jan derguar nga dergues me emer dhe mbiemer nga shtete te ndryshme.

**-Raporti i Bankës Ekonomike** i dt. 18 shkurt 2015 lidhur me llogarinë bankare të të pandehurit L. I, ku eshte dhene menyra e hapjes se gjirollogarise dhe transaksionet e kryera ne kete banke.

**-Raporti i Agjensionit Finaciar DHTHM** i dt. 24 shkurt 2015 për tasanksonet e kryera përmes agjensionit Monegram, sipas te cilit jan gjetur dy transaksione te kryera nga personi me emerin L. I

**-Pasqyra e llogarisë bankare e Violeta Isufit** në Raiffeisen bank për periudhën kohore prej dt. 18.04.2008 deri më 15.04.2015.

**-Raporti nga Unioni financiar Prishtine** me nr. 49, date 10.02.2015 lidhur me transaksionet e kryera me rrejtin e unionit financiar është union në emër të L. I sipas të cilit L. I ka terhequr shuma të ndryshme të parave nga dergues të ndryshëm, nga shtete të ndryshme si Zvicrra, Kina Ecuadori , Rusia e tj.

**-Raporti nga Unioni financiar Prishtin sh.p.k** i dt. 16 prill 2015 me nr. 96 lidhur me trasaksionet e kryera në rrjetin e Wester Unionit në emër të M. I, V. A H. I, A. M dhe Sh. K

H. I nga Western Union prej dates 30.06.2012 e deri me 17.03.2014 ka terhequr të holla në shume prej 16,783.15 euro në shuma të ndryshme kryesisht dergues kanë qenë nga Kina, një nga Zvicrra dhe një nga Gjermania, me emra dhe mbiemra.

Raporti I unionit financiar nr. 96, M. I ka pranuar shuma të ndryshme 26 here nga dergues të ndryshme kryesisht nga Kina, Violet Arifi ka pranuar një here të holla, ndërsa H. I ka pranuar 14 here të holla nga dergues kryesisht nga Kina, shuma të ndryshme.

**-Infomrata nga Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë** - Agjensioni për regjistrimin e bizneseve lidhur me biznesin e regjistruar në emër të L. I , sipas të cilit raportit L. I është pronar i biznesit N.T.SH. "...", NR. BIZNESIT ... I regjistruar me 13.10.2011.

**-Ifnormata nga ATK** - Njësia e Hetimeve nga ATK dhe Intelegjencës e dt. 6 shkurt 2015 për të pandehurin L. I lidhur me subjektin afarist N.T.SH. "NATUR- MED", sipas të cilit raport ky biznes gjendet në listën e bizneseve pasive që nga data 31.03.2014.

Në bazë të raportit të ATK-se të dates 30.11.2017, L. I dhe familjaret e tij kanë përfituar Shumen prej 73.477.18 euro.

**-Raporti përmbledhës i zbulimit të të dhënave financiar hartuar nga Policia e Kosovës** i hartuar më dt. 26 mars 2016 në emër të L.I, sipas këtij raportit L. I nuk ka atë hapur llogari në Teb Bank, BKT, BPB, Vllesa Co, DMTH, Monej Gram dhe Raifaisen Bank.

Ka llogari në NLB Bank dhe nga data 23.11.2011 e deri me 06.06.2012 ka deponuar 7 here nga 250 euro, vlera e përgjithshme 1.750 euro, ndërsa ka



terhequr 27 here shuma te ndryshme te parave, qe nga data 25.11.2011 e deri me 15.05.2013 te gjitha ne shume te pergjithshme prej 1983.52 euro.

Ne mer te biznesit ... nuk ka qarkullim.

Nepermjet DMTH SHPK Money Gram ne Raifaisen, L. I ka terhequr shumat e ndryshme te parave duke filluar nga viti 2011 e deri me 11.08.2014, ne shume te pergjithshme prej 4.195.38 euro.

Qe nga data 2012 e 2013 ka pranuar 41 nji here shuma te ndrsyhme te parave ne USD nga shtete te ndryshme Kina, Amerika, Rusia Zvicrra e the dhe ate ne shume te pergjithshme prej 30.728.65 euro ose 39.011.00 Dollar, 113.90 CHF dhe 423.00 GBP.

**-Raporti përmbledhës** i zbulimit të të dhënave financiar haartuar nga Policia e Kosovës i hartuar në emër të M. I „... , Hatixhe isufi , A. M dhe Sh. K .

Sipas ketij raporti M. I ka terhequr para nga Western Unionon dhe ate gjate vitit 2013 dhe 2014 shuma te ndryshme te parave (26 here) nga dergues nga Kina ne shume te pergjithshme prej 25.348,49 euro.

V. A ka bere nji pagese me Western Union ne kuader te Raifaisen Bank me date 19.04.2014 ka bere nji dergese ne USA, marrsi F. A, vlera 2.000.00 euro.

Me date 01.04.2014 ka pranuar Shumen prej 640.58 euro nga Yan Toe nga shteti I Kines, me date 14.03.2015 ka derguar Shumen prej 150 euuro ne emer te Fl. A

H. I gjate viti 2012 ka pranuar dy shuma prej nga 130 dhe 50 euro nga Zvicrra dhe Gjermania, ndersa ne vitin 2014 ka pranuar 12 here te holla nga Kina, te gjitha ne shume te pergjithshme prej 16.783.15 euro.

A. M nuk ka transaksione te dyshimta.

Sh. K nuk ka transaksione te dyshimta.

**-Raporti mbi rezultatet e egzaminimit sipas urdhëresë të punuara nga Policia e Kosovës - sektori për fotografi , videoanaliz dhe egzaminim të IT njësia për egzaminime e IT për paisjet në emër të L. I me nr. 2014 - DKKO -... dt. 19 qershor 2016.**

**-Raporti mbi rezultatet e egzaminimit sipas urdhëres të punuar nga Policia e Kosovës sektori për fotografi videoanaliz dhe egzamiinim të IT , njësia për egzaminime e IT për paisjet në emër të L. Sh me nr. 2014 - DKKO - ... dt. 19 qershor 2016.**

**-Raporti mbi rezultatet e egzaminimit sipas urdhëres të punuar nga Policia e Kosovës, sektori për fotografi videoanaliz dhe egzamiinim të IT**

, njësia për egzaminime e IT për paisjet në emër të L. M me nr. 2014 – DKKO - ... dt. 19 shtator 2016.

**-Raporti mbi rezultatet** e egzaminimit të paisjeve të të pandehurve L. I L.sh dhe L. M me nr. ... dt. 19 shtator 2016

**-Fotoalbumet e paisjeve** të sekuestruara nga të pandehurit të punuara nga Drejtoria Kriminalsitike të dt. 18 gusht 2015

**-Raporti i ekspertizës** të punuar nga Drejtoria e teknikës Kirminalistike për paisjet e sekuestruara nga të pandehurit - aktvenidmi për angazhimin e ekspertit nga Fakultetit i inxhinieris elektrike dhe kompjuterike pranë UP PPNJ nr. .... 29 nëntor 2016.

**-Ekspertiza** e punuar nga Fakulteti i inxhinerisë elektrike dhe kompjuterike prof. Ass Dr. B.R dt. 27.03.2017, në të cilën është konstatuar:

### **Lavdim Mjekiqi:**

Raporti për të pandehurin L.M përmban 3065 faqe të nxjerra nga laptopi Samsung me disk 500 GB (...), dhe jap këto vlerësime lidhur me pyetjet e prokurorit:

### **I.Kredenciale**

Folderi “Downloads” përmban mbi 49 fajlla (dokumente) në të cilat janë në total afër 10.000 kredenciale (IP adresa, unersname dhe password) për qasje në largësi të kompjuterëve (serverëve) të ndryshëm, me adresa fizike (gjeografike) kryesisht në SHBA. Vetëm fajlli “spamtool\_shop\_accounts.sql” ka 5.286 kredenciale! Me këto kredenciale mundësohet qasje e papenguar në këta server. Veglat (tools) të gjetura në këtë folder (Doënloads) përdoren për qasje në largësi (FileZilla) dhe kryerjen e pagesave përmes internet (Bitcoin).

### **II.Kredit Kartela**

Folderi “D3/En\_Raport\_D3/Users/I.../Desktop/Neë folder/fullz(1)” përmban një fajll me 765 shënime të plota për kredit kartela të personave real (banor kryesisht në SHBA) por ekzistojnë edhe fajlla të tjerë që përmbajnë shënime të kredit kartelave.

## **II. Intervali kohor**

Në bazë të aktiviteteve të zhvilluara në internet, shih dëshmit IEF (Internet Evidence Finder) nga hetuesia, intervali kohor është gjatë tërë vitit 2014 dhe pjesa e parë e vitit 2015. Edhe pse validiteti I kredit kartelave të përdorura është që nga viti 2011 e tutje.

## **IV. Të dëmtuarit**

Të gjitha palët që janë listuar përmes IP adresës (serverët), bizneset që kanë pasë të hostuar shërbimet e tyre në këto server dhe persona juridik (qytetarë me emër dhe mbiemër), kredit kartelat e të cilëve janë listuar në këto fajlla mund të jenë palë të dëmtuara.

## **V. Shitja e kredit kartelave në forume**

Nga dëshmitë e prezantuara (raporti I forenzikës IEF) shihet që I dyshuari ka pasë disa llogari bankare (për pagesë përmes internetit), siq janë në: Paypal, Ebay, Fedex, ëalmart etj. Dhe ka bërë tregti (shit/blerje) të kredencialave (username / password, kredit kartela etj.) të ndryshme në forume të ndryshme si: Skype, Chatroulette, Msn, Yahoo Messenger, etj.

## **VI. Nërhyrje e paautorizuar në sisteme kompjuterike**

Në bazë të dëshmive nga raporti i forenzikës IEF (Internet Evidence Finder) si dhe pikës I (kredencialet - username / password) dhe pikës II (kredit kartelat), I dyshuari jo vetëm që ka pasë në posedim me mijëra qasje të tilla por ato edhe I ka përdorur ato (shih logun e mesazhe nga forumet).

## **L. I**

### **4**

Raporti për të pandehurin Liridon Isufi përmban 11 foldera dhe në secilën janë mijëra faqe raporte të forenzikës me veglën IEF (Internet Evidence Finder) dhe të përmbledhura në pdf document të nxjerra nga paisjet elektronike (PC me disqe të ndryshme) të sekuestruara nga policia.

## **I. Kredenciale**

Në dëshmitë (folderat), e ofruar me miliona email nga e mbarë bota (SHBA, Gjermani, Britani e Madhe etj). Për dhjetëra mijëraë emaila janë edhe fjalëkalimet përkatëse të tyre, gjë që mundëson qasje në këto emaila pa lejen e pronarit. Po ashtu në këto foldera janë me mijëra kredenciale (IP adresa, username dhe password) për qasje në largësi të kompjuterëve

(serverëve) të ndryshëm, me adresa fizike (gjeografike) kryesisht në SHBA. Në këto foldera janë gjetur edhe adresa për pagesa përmes internetit si Bitcoin.

## **II.Kredit kartela**

Në folderin “D3/En\_RaportiD3/Volume 2” janë gjetur instruksione për shkrimin e shiritave magnetic të kredit kartelave. Këta foldera, mbi 11 në raport, janë me mijëra shënime për kartela të kredit të përgatitura për të fut (insertuar) në ndonjë bazë të shënimeve. Këto shënime janë me emra real kryesisht nga SHBA.

## **III.Intervali kohor**

Në bazë të aktiviteteve të zhvilluara në internet, shih dëshmitë IEF (Internet Evidence Finder) nga hetuesia, intervali kohor është nga viti 2011 deri te pjesa e parë e vitit 2015.

## **IV.Të dëmtuarit**

Të gjitha palët që janë listuar përmes IP adresës (serverët), bizneset që kanë pasë të hostuar shërbimet e tyre në këto server dhe persona juridik (qytetarë me emër dhe mbiemër), kredit kartelat e të cilëve janë listuar në këto fajlla mund të jenë palë të dëmtuara. Shumat e parave ndryshojnë nga dhjetëra dollarë e deri në qindra dollar për shfrytëzues!

## **V.Shitja e kredit kartelave në forume**

Nga dëshmitë e prezantuara (raporti I forenzikës IEF) shihet që I dyshuari ka pasë disa llogari bankare (për pagesë përmes internetit), siq janë në: Paypal,Ebay, Fedex, ëalmart etj. Dhe ka bërë tregti (shit/blerje) të kredencialave (username / password, kredit kartela etj.) të ndryshme në forume të ndryshme si: Skype, Chatroulette, Msn,Yahoo Messenger, Mail.ru etj.

## **VI.Ndërhyrje e pautorizuar në sistemet kompjuterike**

Në bazë të dëshmimeve nga raporti i forenzikës IEF (Internet Evidence Finder) si dhe pikës I (kredencialet - username / password) dhe pikës II (kredit kartelat), I dyshuari jo vetëm që ka pasë në posedim me mijëra qasje të tilla por ato edhe I ka përdorur ato (shih logun e mesazhe nga forumet).

## **L. Sh**

Raporti për të pandehurin L. Sh përmban 14 foldera dhe në secilën janë mijëra faqe raporte të forenzikës me veglën IEF (Internet Evidence Finder) dhe të përmbledhura në pdf document të nxjerra nga paisjet elektronike (PC me disqe të ndryshme) të sekuestruara nga policia.

### **I.Kredenciale**

Në dëshmitë (folderat), e ofruar me miliona email nga e mbarë bota (SHBA, Gjermani, Britani e Madhe, Australi, etj). Se bashku edhe me fjalkalimet (passëord) e tyre që mundëson qasje në këto emaila pa lejen e pronarit. Po ashtu në këto foldera janë me mijëra kredenciale (IP adresa, username dhe password) për qasje në largësi të kompjuterëve (serverëve) të ndryshëm, me adresa fizike (gjeografike) kryesisht në SHBA.

### **II.Kredit kartela**

Vetëm në folderin “D5/Dekstop Work/ interfejs fakultet” janë gjetur mbi 80.000 shenime për kredit kartela, të përgatitura për ti fut (insertuar) në ndonjë bazë të shënimeve. Këto shënime janë me emra real kryesisht nga SHBA. Nga shënimet që janë nuk mund të konkludohet për dëmet që mund të jenë shkaktuar.

### **III.Intervali kohor**

Në bazë të aktiviteteve të zhvilluara në internet, shih dëshmitë IEF (Internet Evidence Finder) nga hetuesia, intervali kohor gjatë tërë vitit 2014 dhe deri në gusht të vitit 2015.

### **IV.Të dëmtuarit**

Të gjitha palët që janë listuar përmes IP adresës (serverët), bizneset që kanë pasë të hostuar shërbimet e tyre në këto server dhe persona juridik (qytetarë me emër dhe mbiemër), kredit kartelat e të cilëve janë listuar në këto fajlla mund të jenë palë të dëmtuara.

### **V.Shitja e kredit kartelave në forume**

Nga dëshmitë e prezantuara (raporti I forenzikës IEF) shihet që I dyshuari ka pasë disa llogari bankare (për pagesë përmes internetit), siq janë në: Bitcoin ,Ebay, etj. dhe ka bërë tregti (shit/blerje) të kredencialave (username / password, kredit kartela etj.) të ndryshme në forume të ndryshme si: Skype, QQ, Yahoo Messenger, etj.

## **VI.Ndërhyrje e pautorizuar në sistemet kompjuterike**

Në bazë të dëshmive nga raporti i forenzikës IEF (Internet Evidence Finder) si dhe pikës I (kredencialet - username / password) dhe pikës II (kredit kartelat), I dyshuari jo vetëm që ka pasë në posedim me mijëra qasje të tilla por ato edhe i ka përdorur ato (shih logun e mesazhe nga forumet).

**- Raporti nga ATK** e dt. 30 nëntor 2017 për aktivitetin e tatimpaguesit ntsh'' ... me pronar të pandehurin L. I lidhur me obligimin tatimor

**-Akt prëcjellës** nga Ministria e Drejtësisë - Departamenti për bashkpunim ndërkombëtar i dt. 12 nëntor 2015.

**-Trankripti i përgjimeve** telefonike të të pandehurve L.I, L. Sh dhe L. M, ku shifet se te njejtit kan komunikuar ndermjet vedi, ndersa ne transkriptin e dates 05.07.2017 L. M I thot L. I " do shella ti bana gati", ndersa L... I thot "ta ha loqken".

**-Përgjegjja nga Departamenti** i drejtësisë nëSHBA me nr. ... i dt. 26 tetor 2015 së bashku me 2 CD.

- CD me të dhënat e L.I,
- CD me të dhënat e L.SH
- CD me të dhënat e L: M

**-Aktvendimi i Prokurorisë Themelore** në Gjilan - DKR, PP.I.nr. 18/2017 dt. 9 korrik 2019 kundër të pandehurit Aron Bajra, sipas te cilit eshte hudhe kallximi penal ndaj te pandehurit Aron Bajra, ne mungese te provave.

### **Mbrojtja e te akuzuarve;**

**I akuzuari L. I,** deklaron se ka dhënë deklaratë në Prokurori dhe Polici lidhur me këtë çështje.

Mbetem në tërësi pranë deklaratës e dhënë në Prokurori ndërsa në Polici jo.

Asnjëherë nuk ka ndërhy në të dhënat kompjuterike të personave të tjerë, në asnjë rast.

Kompania yohao.com është kompani ku mund të hapen email- prej krejt botës. Secili njeri në botë mundet me hap email.

Nuk i kujtohet se a ka pas email në këtë kompani personalisht apo jo.

Asnjëherë nuk ka vjedhur- kopjuar të dhënat e ndjeshme të personave të tjerë të llogarive bankare.

Nuk ka kriju kurfarë servere të veqantë sepse kjo shërben vetëm për hapjen e emailive.

Nuk ka pas kurfarë web faqe për shitjen e programeve të ndryshme për infektimin e kompjuterve .

Nuk e di se çka është Shell-i.

Nuk e di se çka është Tell shopi, por eshte njoftu me të kur eshte arrestu.

Me rastin e hapjes së email mund të futen shënime personale por mund të futen edhe shënime të rrejshme.

Përmes emailit nuk ka mundësi me kriju as programe as dizajne.

Ka kry shërbime dhe dizajne për programin të ndryshme për personat të cilit kanë pas qasje në wepsajd Frillanceer e cila edhe sot e kësaj dite, egziston dhe është e qasshme për punë dhe dizajne të ndryshme prej nga e gjithë bota.

Për këto programe dhe dizajne ka pas përfitim.

Programet dhe dizajnet ky vetë i ka përpilu edhe e kan pas çmimin e vet dhe ju ka kryer shërbim personave që janë paraqit.

Ato nuk ka mujt askush me i shfryëzu përveq tij.

Këto të holla për të cilat akuzohem janë të gjitha të fituara nga këto programe.

Arsyea pse disa të holla kanë ardhur edhe në emër të familjarve është për shkakun se ky nuk ka qenë këtu, kam qenë në Zvicërr e në vende të tjera – ka qenë me vizë të rregullt.

Email I tij ka qenë [...](#)

Email. ... etj sikur në procesverbalin e dt. 26.11.2015 nuk janë të emajlat te tije.

Nuk ka pas asnjë ankese lidhur me programet që i ka krijuar. Asnjëherë nuk ka falsifiku letra me vlerë apo instrumete pagese.

Nuk ka ndërhy me qëllim keqbersë në sisteme kompjuterike.

Ka pas një firmë me emrin' ...,mirëpo nuk ka qenë funksionale asnjherë. Këtë firmë e kanë regjistruar në emër e tije, motra dhe dhëndrri që punojnë në Zvicër, me qëllim të importimit të disa barnave bio, mirëpo nuk kanë arritur dhe me kaq ka përfunduar , nuk është bërë asnjë trasanksion nëpërmjet kësaj firme.

Me rastin e arrestimit i është sekuestruar Llaptopi personal dhe të familjarëve, me sa më kujtohet 1 llaptop i nipit ....

1 i motrës V. A poashtu edhe një tjetër llaptop i motrës Sh. I vetura ime ... 950 Euro që i kam pasur në kulet, 1 Iphon 6.

Dizajnet që i ka bërë janë të ndryshëm, varsisht nga shija e konsumatorit – blerësit.

Nuk eshte marrë me njerëz prej Kosove, sepse nuk ja din vlerën.

Sa i përket dekalrataës të eksperimentit të kibernetikës, që gjëja në llaptopat e sekuestrum janë gjet kredenciale nuk ka përgjigje dhe ato nuk i kam përdorë asnjëher dhe nuk kam pas.

Në familjen e tije ky e njëj kompjuerin ma mir.

Edhe pse emaili e ka numrin e tij të telefonit, ato nuk janë të tiat, sepse në rastin e hapjes së email mundet me vendos qfardo numri.

Nuk ka përgjigje në lidhje me deklarinimin e ekspertit se në kompjuterat është gjet program i qasjes nga largësia.

Sa i përket bisedës telefonike me Lavdimin, ku i njëjti ka thanë se ti kam bo do Shella gati, kjo do të thotë dizajnë i emërtuar me emrin Shell.

Nuk më kujtohet se çfarë programi kemi përdorë për dizajne, se është bërë 5 vite.

Një personi nga Kina është e vërtetë që ia ka mirembajte Qanellat të cilat janë rubrika në You tube, për me fut video të ndryshme. Në kontakt me të ka ra përmes internetit.

Ka të përfunduar shkollën e mesme drejtimi matematik- informatik.

Nuk ka të kryer ndonjë kualifikim për dizjen dhe programe.

Me klient kan ra në kontat përmes wepsaid -frizer.

**I akuzuari L. Sh** deklaron se ka dhënë deklaratë në Prokurori ndërsa në Polici jo.

Mbetet në tërësi pranë kësaj deklarate.

Sa i përket veprës penale falsifikimi i letrave me vlerë, nuk e di se çka është kjo vepër, ndërsa sa i përket veprës penale ndërhyrje në sistemin kompjuterik unë nuk e di se ku kam ndërhy dhe në jetën time nuk e di që kam ndërhy në rrjet kompjuterik.

Në atë kohë kur e kan arrestu ka punu me you tube - video , ka pas edhe një loje që e ka lujtë.



Nuk e di se ku janë gjetur IP adresat në lloptop dhe mu nuk ma ka dokumentu se çka është ajo dhe qasjen.

Nuk ka bërë shitbjerje online.

Ka pas disa video që nuk janë publiku në you tube, I ka marrë i ka publiku, filma vizatimor për fmi dhe në bazë të klikimeve ka fitur.

H. K e kam njohur pak dhe mu ka dok burr i mirë, të cilit ia kam kërku 3.000 Euro borgj për hapjen e një lokalit në ...

Lidhur me përfitimet në bazë të klikimeve që i ka fitu nuk ka pas asnjë përfitim me L... dhe L...

**I akuzuari L. M** pohon se ka dhënë deklaratë në Prokurori, mirëpo ka harru se çka ka deklaruar.

Ka të kryer shkollën e mesme drejtimi natyror.

Kompjuterin e njehe deri dikun nëpër rrjete sociale.

Nuk ka ndërhy në sistem kompjuterik dhe nuk kam njohuri për të.

Nuk e di domethanjën e fjalës Shell.

Nuk di me kriju ndonjë program në kompjuter.

Asnjëherë nuk ka ndërhy në të dhënat personale të personave të tjerë dhe as nuk ka bërë pagesa nga gjirrollogaritë e huaja.

Nuk kam përfitu as gjë nga asnjë aktivitet, sepse nuk ka pasur aktivitetet të tilla në kopjuter.

Nuk ka njohuri se në lloptopin e tije janë gjetë të dhënat personale për Pay pall.

E-bai e ka personal, por nuk ka njohuri se janë gjetur e-bai tjerë.

Gjithashtu nuk ka njohuri që janë gjet shënime të kredit kartelave të huaja në kompjuterin e tije.

Shelli është sistem operativ, që mundet me përdorë gjithkush, ky sistem përdoret për lojna , dizajna.

Nuk i kujohet që i ka thënë L... ti pregadita do Shella

Në lloptopin e tije, askush nuk ka pas qasje përveq atij.

**Fjala përfundimtare e paleve;**

**Prokurori i shtetit Arben Kadriu** në fjalën përfundimtare deklaron:

Ka mbetur pranë aktakuzës në të gjitha pikat me përjashtim të pikës III të aktakuzës ndaj të akuzaurit L.I për shkak të veprës penale shmangje nga tatimi nga neni 313 par 3 nënpar 1 të KPRK, është tërhiqur nga kjo pikë e aktakuzës.

Sa i përket pikave të tjera të aktakuzës mbetem pranë të njejtës – pandryshuar konsideron, që gjatë shqyrtimeve gjyqësore është vërtetuar gjendja faktike dhe fajësia e të akuzuarve, për shkak të veprave penale të përshkruar si në aktakuzë dhe se fajësia e të akuzuarve vërtetohet nga provat materiale të cilat janë të shtjelluara gjatë shqyrtimve gjyqësore e sidomos me ekspertizën nga Fakulteti i nxhinierisë teknike dhe kompjuterike të dt. 27 mars 2017 dhe pashtu edhe me dëgjimin e ekspertit B. R në shqyrtimet e kaluara gjyqësore.

Nuk është kontestuese fakti se në paisjet elektronike të sekuestruara nga të 3 të akuzuarit gjatë egzaminimit të tyre janë gjetur gjithmon në bazë të ekspertizës së ekspertit, të dhëna për kredit kartel me të gjitha elementet tjera të sigurisë të cilat mund ti ketë një kreditkartelë e çka konsiderojmë se vetëm ose posedimi i tyre përbene vepër penale. Propozoj që të njejtit të shpallen fajtor dhe të dënohet me dënim meritor sipas KPRK.

Si rrethana rënduese propozoj që të merren parasysh shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale, ndërsa si rrethana lehtësuese mosha e të akuzuarve dhe se nga koha kur edhe dyshohet se kanë kryer veprë penale ka kaluar më 5 vite.

**Avokati Ymer Huruglica** ne fjalën perfundimtare e ka paraqitur me shkrim, ne te cilen ka deklaruar, se mbrojtja konsideron se nuk eshte vertetuar pertej dyshmit te bazuar se I akuzuari L.I ti kete kryer veprat penale te cilat I vehen ne barre. I ka propozuar gjykates qe te bjen aktgjykim lirues per te akuzuarin L.I

I njejti e ka kontestu periudhen kohore te vitit 2007 kur L.I ka qen I mitur, e ky trup gjykues nuk ka mundur ta gjykoi, por ai per te mitur. Gjithashtu Ligji per per parandalimin e Krimet Kibernetik i clli ka hyre ne fuqi ne vitin 2010 nuk munde te zbatohet te ky I pandehur, sepse aktakuza perfshin nji periudhe para hyrjes ne fuqi te ketij ligji, qe nga viti 2007.

Fakti se I akuzuari dhe familjaret e tij kan pranuar te holla sikurse ne piken I. te aktakuzes, I akuzuari ka ofruar prova dhe fakte qe ka bere dizajne te programeve ne internet dhe ato dizajne I ka shitur.

Ka kerkuar lirimin e te mbrojturit te tij nga dy veprat penale qe I vihen ne barre.

**I akuzuari L.I**, e ka perkrahe ne tersi fjalën perfundimtare te Avokatit te tij.

**Avokati Vehbi Ismaili** fjalën perfundimtare e ka dorzuar me shkrim, ne te cilen e ka kundërshtuar aktakuzën e Prokurorisë, duke theksuar se me asnjë prove nuk është vertetuar se I mbrojturi I tij L. Sh te I kete kryer veprat penale te cilat I vehen ne barre. Ka kerkuar Aktgjykim lirues.

**I akuzuari L.Sh** në fjalën përfundimtare është pajtuar në tërësi me fjalën përfundimtare të mbrojtësit te tij.

**Avokati Selami Rexhepi** fjalën perfundimtare e ka dorzuar me shkrim, ne te cilen ne tersi e ka kundërshtuar aktakuzën e prokurorisë, duke theksuar se me asnjë prove nuk është vertetuar, se klienti I tij ti kete kryer veprat penale te cilat I vihen ne barre.  
Ka kerkuar Aktgjykim lirues.

**I akuzuari L. M** është pajtuar me fjalën perfundimtare te mbrojtësit te tij

**Gjykata pasi I analizoi provat e administruara** dhe mbrojtjen e te akuzuarve konstatoi; Veprat penale falsifikim i letrave me vlere dhe instrumenteve të pagesës nga neni 293 paragrafi 4 e lidhur me paragrafin 1 e 2 te KPRK-se, qe akuzohen qe te tre te akuzarit, dispozitivat II. V. dhe VII. te aktakuzes, kjo veper penale kryhet duke prodhuar letra me vlere te falsifikuara apo instrumente te pageses te falsifikuara, ndryshim i letrava me vlere , me qellim te perdorimit si te verteta, apo per ti dhene tjetrit t'i perdore dhe perdorimi i letrave me vlere te falsifikuara si te verteta. Prodhim i letrave me vlere apo instrumente te pageses , është punim dhe dhenia e formes dhe pamjes se letrave te permendura, ndersa ndryshimi do te thote ndryshim i letrave me vlere apo instrumentit te pageses egzistuese, psh. ndryshimi i vleres se saje, ndryshimi i dates se perdorimit, ndryshimi i vules e tj. Prodhimi, ndryshimi, prokurimi dhe dhenia e letrave me vlere te falsifikuara personit tjetër , paraqesin veprime me te cilat kryhet kjo veper penale, vetem nese keto veprime jan ndermarre me qellim qe letrat me vlere apo instrumentet e falsifikuara te perdoren si te verteta.

Nese anlizohen dispozitivat e aktakuzes, sa i perket kesaje vepre penale, per te gjithë te akuzuarit, dhe ate dispozitivave te veqant per sejcilin te akuzuar, II. V. dhe VII. fjala eshte per vepra te njeta per te cilen akuzohen te akuzuarit ne dispozitivin I. IV. dhe VI. te aktakzues dhe ate vepren penale hyrje në sistemet kompjuterike nga neni 339 par.2 lidhur me para.1 te KPRK-së dhe veprës penale nga neni 13 par.3 dhe neni 15 par.1 te Ligjit mbi parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetike, falsifikim i letrave me vlere.

Ne dispozitivin II.V. dhe VI te aktakuzes, thuhet ne menyre identike se te pandehurit **L.I, L.Sh dhe L. M**, përmes ndërhyrjeve në sistemin kompjuterik të shfrytzuesve të internetit me programe keqëbërse të qasjes në sistemet kompjuterike të huaja nga largsia i kan kopjuar të dhënat e kartelave bankare, permbajtjen e shiritit magnetic, fjalekalimet dhe në këtë mënyrë keto instrumente të pagesave si të dhënat e kartelave bankare në bazë të ekspertizës së ekspertit të Inxhinjerise kompjuterike, kan bërë shitjen e kredit kartelave në forume te ndryshme, e qe korrespondon me vepren penale hyrje në sistemet kompjuterike nga neni 339 par.2 lidhur me para.1 te KPRK-së dhe veprës penale nga neni 13 par.3 dhe neni 15 par.1 te Ligjit mbi parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetike, falsifikim i letrave me vlere, per te cilen te akuzuarit jan shpalle fajtor.

Ne dispozitivat e aktakuzes II.V. dhe VII. ne asnje pjese te tyre, nuk thuhet se te akzuarit kan prodhuar letra me vlere te falsifikuara apo instrumente te pageses te falsifikuara, ndryshim i letrava me vlere , me qellim te perdorimit si te verteta, apo per ti dhene tjetrit t'i perdore dhe perdorimi i letrave me vlere te falsifikuara si te verteta.

Per kete arsye te akuzuarit L. I, L Sh dhe L M jan liruar nga akuza, per shkak te veprave penale falsifikim I letrave me vlere dhe instrumenteve te pageses nga neni 293 par.4 e lidhur me paragrafin 1 e 2 te KPRK-se, respektivisht dispozitivit II. Per L. I, dispozitivit V. per L. Sh dhe dispozitivi VII. per L. M, fjala eshte per dispozitivat e Aktakuzes, apo despozitivat II.III. dhe IV te aktgjykimit.

**Sa I perket veprave penale qe ngarkohen te akuzuarit, Hyrje ne sistemin kompjuterik nga neni 339 par.2** lidhur me paragrafin 1 te KPRK-se dhe vepres penale nga neni 13 para.3 dhe neni 15 par.1 te Ligjit te parandalimit dhe luftimin e krimit kibernetik dispozitivi I. per te

akuzuarin L. I, dispozitivi IV. Per te akuzuarin L. Sh dhe dispozitivi VI. Per te akuzuarin L. M, gjykata ka ardhur ne perfundim se te njejtit I kan kryer keto vepra penale, duke u bazuar ne ekspertizen e punuar nga Fakulteti i inxhinerisë elektrike dhe kompjuterike prof. Ass Dr. B. R dt. 27.03.2017, në të cilën është konstatuar:

## **L. M**

Raporti për të pandehurin L. M përmban 3065 faqe të nxjerra nga laptopi Samsung me disk 500 GB (...), dhe jap këto vlerësime lidhur me pyetjet e prokurorit:

### **I.Kredenciale**

Folderi "Downloads" përmban mbi 49 fajlla (dokumente) në të cilat janë në total afër 10.000 kredenciale (IP adresa, unersname dhe password) për qasje në largësi të kompjuterëve (serverëve) të ndryshëm, me adresa fizike (gjeografike) kryesisht në SHBA. Vetëm fajlli "spamtool\_shop\_accounts.sql" ka 5.286 kredenciale! Me këto kredenciale mundësohet qasje e papenguar në këta server. Veglat (tools) të gjetura në këtë folder (Doënloads) përdoren për qasje në largësi (FileZilla) dhe kryerjen e pagesave përmes internet (Bitcoin).

### **II.Kredit Kartela**

Folderi "D3/En\_Raport\_D3/Users/Ilir/Desktop/Neë folder/fullz(1)" përmban një fajll me 765 shënime të plota për kredit kartela të personave real (banor kryesisht në SHBA) por ekzistojnë edhe fajlla të tjerë që përmbajnë shënime të kredit kartelave.

### **II.Intervali kohor**

Në bazë të aktiviteteve të zhvilluara në internet, shih dëshmit IEF (Internet Evidence Finder) nga hetuesia, intervali kohor është gjatë tërë vitit 2014 dhe pjesa e parë e vitit 2015. Edhe pse validiteti I kredit kartelave të përdorura është që nga viti 2011 e tutje.

### **IV.Të dëmtuarit**

Të gjitha palët që janë listuar përmes IP adresës (serverët), bizneset që kanë pasë të hostuar shërbimet e tyre në këto server dhe persona juridik ( qytetarë me emër dhe mbiemër), kredit kartelat e të cilëve janë listuar në këto fajlla mund të jenë palë të dëmtuara.

## **V. Shitja e kredit kartelave në forume**

Nga dëshmitë e prezantuara (raporti I forenzikës IEF) shihet që I dyshuari ka pasë disa llogari bankare (për pagesë përmes internetit), siq janë në: Paypal, Ebay, Fedex, ëallmart etj. Dhe ka bërë tregti (shit/blerje) të kredencialave (username / password, kredit kartela etj.) të ndryshme në forume të ndryshme si: Skype, Chatroulette, Msn, Yahoo Messenger, etj.

## **VI. Nërhyrje e paautorizuar në sisteme kompjuterike**

Në bazë të dëshmimeve nga raporti i forenzikës IEF (Internet Evidence Finder) si dhe pikës I (kredencialet - username / password) dhe pikës II (kredit kartelat), I dyshuari jo vetëm që ka pasë në posedim me mijëra qasje të tilla por ato edhe I ka përdorur ato (shih logun e mesazhe nga forumet).

### **L. I**

Raporti për të pandehurin Liridon Isufi përmban 11 foldera dhe në secilën janë mijëra faqe raporte të forenzikës me veglën IEF (Internet Evidence Finder) dhe të përmbledhura në pdf document të nxjerra nga paisjet elektronike (PC me disqe të ndryshme) të sekuestruara nga policia.

### **I. Kredenciale**

Në dëshmitë (folderat), e ofruar me miliona email nga e mbarë bota (SHBA, Gjermani, Britani e Madhe etj). Për dhjetëra mijëraë emaila janë edhe fjalëkalimet përkatëse të tyre, gjë që mundëson qasje në këto emaila pa lejen e pronarit. Po ashtu në këto foldera janë me mijëra kredenciale (IP adresa, username dhe password) për qasje në largësi të kompjuterëve (serverëve) të ndryshëm, me adresa fizike (gjeografike) kryesisht në SHBA. Në këto foldera janë gjetur edhe adresa për pagesa përmes internetit si Bitcoin.

### **II. Kredit kartela**

Në folderin "D3/En\_RaportiD3/Volume 2" janë gjetur instruksione për shkrimin e shiritave magnetic të kredit kartelave. Këta foldera, mbi 11 në raport, janë me mijëra shënime për kartela të kredit të përgatitura për të fut (insertuar) në ndonjë bazë të shënimeve. Këto shënime janë me emra real kryesisht nga SHBA.

### **III. Intervali kohor**

Në bazë të aktiviteteve të zhvilluara në internet, shih dëshmitë IEF (Internet Evidence Finder) nga hetuesia, intervali kohor është nga viti 2011 deri te pjesa e parë e vitit 2015.

#### **IV.Të dëmtuarit**

Të gjitha palët që janë listuar përmes IP adresës (serverët), bizneset që kanë pasë të hostuar shërbimet e tyre në këto server dhe persona juridik (qytetarë me emër dhe mbiemër), kredit kartelat e të cilëve janë listuar në këto fajlla mund të jenë palë të dëmtuara. Shumat e parave ndryshojnë nga dhjetëra dollarë e deri në qindra dollar për shfrytëzues!

#### **V.Shitja e kredit kartelave në forume**

Nga dëshmitë e prezantuara (raporti I forenzikës IEF) shihet që I dyshuari ka pasë disa llogari bankare (për pagesë përmes internetit), siq janë në: Paypal, Ebay, Fedex, ëalmart etj. Dhe ka bërë tregti (shit/blerje) të kredencialave (username / password, kredit kartela etj.) të ndryshme në forume të ndryshme si: Skype, Chatroulette, Msn, Yahoo Messenger, Mail.ru etj.

#### **VI.Ndërhyrje e pautorizuar në sistemet kompjuterike**

Në bazë të dëshmimeve nga raporti i forenzikës IEF (Internet Evidence Finder) si dhe pikës I (kredencialet - username / password) dhe pikës II (kredit kartelat), I dyshuari jo vetëm që ka pasë në posedim me mijëra qasje të tilla por ato edhe I ka përdorur ato (shih logun e mesazhe nga forumet).

#### **L. Sh**

Raporti për të pandehurin Lum Shkodra përmban 14 foldera dhe në secilën janë mijëra faqe raporte të forenzikës me veglën IEF (Internet Evidence Finder) dhe të përmbledhura në pdf document të nxjerra nga paisjet elektronike (PC me disqe të ndryshme) të sekuestruara nga policia.

#### **I.Kredenciale**

Në dëshmitë (folderat), e ofruar me miliona email nga e mbarë bota (SHBA, Gjermani, Britani e Madhe, Australi, etj). Se bashku edhe me fjalkalimet (passëord) e tyre që mundëson qasje në këto emaila pa lejen e pronarit. Po ashtu në këto foldera janë me mijëra kredenciale (IP adresa,

username dhe password) për qasje në largësi të kompjuterëve (serverëve) të ndryshëm, me adresa fizike (gjeografike) kryesisht në SHBA.

## **II.Kredit kartela**

Vetëm në folderin “D5/Dekstop Work/ interfejs fakultet” janë gjetur mbi 80.000 shenime për kredit kartela, të përgatitura për ti fut (insertuar) në ndonjë bazë të shënimeve. Këto shënime janë me emra real kryesisht nga SHBA. Nga shënimet që janë nuk mund të konkludohet për dëmet që mund të jenë shkaktuar.

## **III.Intervali kohor**

Në bazë të aktiviteteve të zhvilluara në internet, shih dëshmitë IEF (Internet Evidence Finder) nga hetuesia, intervali kohor gjatë tërë vitit 2014 dhe deri në gusht të vitit 2015.

## **IV.Të dëmtuarit**

Të gjitha palët që janë listuar përmes IP adresës (serverët), bizneset që kanë pasë të hostuar shërbimet e tyre në këto server dhe persona juridik (qytetarë me emër dhe mbiemër), kredit kartelat e të cilëve janë listuar në këto fajlla mund të jenë palë të dëmtuara.

## **V.Shitja e kredit kartelave në forume**

Nga dëshmitë e prezantuara (raporti I forenzikës IEF) shihet që I dyshuari ka pasë disa llogari bankare (për pagesë përmes internetit), siq janë në: Bitcoin ,Ebay, etj. dhe ka bërë tregti (shit/blerje) të kredencialave (username / password, kredit kartela etj.) të ndryshme në forume të ndryshme si: Skype, QQ, Yahoo Messenger, etj.

## **VI.Ndërhyrje e pautorizuar në sistemet kompjuterike**

Në bazë të dëshmive nga raporti i forenzikës IEF (Internet Evidence Finder) si dhe pikës I (kredencialet - username / password) dhe pikës II (kredit kartelat), I dyshuari jo vetëm që ka pasë në posedim me mijëra qasje të tilla por ato edhe i ka përdorur ato (shih logun e mesazhe nga forumet).

Keto konstatime jan nxjerrur nga materialet e sekuestruara nga ana e te pandehurve, siq jan Laptop, kpmjuter, CD te ndryshme te cilat kan qen objet I analizes se ekspertit te IT B. R perndryshe Profesor ne Fakultetin Teknik te Univerzitetit Hasan Prishtina ne Prishtine.



Kete ekspert gjykata e ka ndegjuar edhe ne séance gjyqsore, I cili e ka mbrojtur ekspertizen e kryer me shkrim, ne te cilen deklarate Eksperti i inxhinjeris kompjuterike B. R, se nga provat qe i jan dorzuar nga ana e Prokurorise, jan gjetur shenime te ashtuquajtura Kredenciale, te cilat nuk jan te zakonshme te qytetaret e rendomt gjate perdorimit te internet. Keto jan te ashtuquajtura username, password dhe IP adresa. Posedimi i ketyre paraqet mundsi per keqepedorime nga ana e poseduesve, nuk beson se jan perdore te gjitha sepse eshte e pa mundur te perdoren te gjitha.

Ne Harddiskun qe i eshte dorzuar , ka gjetur evidence te forumeve dhe shitblerje te ndryshme, qe u takon pronarve te atij disku. **Te akzuarit nuk e kan krijuar kete shitore per shitblerje**, por kan qen nje nder shume perdoruesit e saje. **Ky ka gjete ne Harddisk se ka pas shitje te atyre kredencialeve, por nuk eshte konstatuar se a kan shitur keta keto kredenciale apo dikush tjeter.**

Ne harddisk ka pas shenime per kredit kartela dhe ate me mija, ne sejcilin folder qe i eshte dorzuar. **Me keto shenime qe jan gjetur eshte e mjaftueshme me bere nje pagese ne shumicen e tyre**, sepse disa kartela kan qen me afat te skaduar. Marrja e ketyre shenimeve per kredit kartela eshte e ndryshme, por nje shembull munde te jete, se nje blerje qe behet ne internet dhe nese nuk ndrrohen shenimet nga shitsi, sepse ai i din shenimet se duhet ta realizoi permes bankes dhe nese ai nuk i mbron, **munde te vie deri te keqepedorimi**, respektivisht marrja e shenimve nga kredit kartela. Kredencilaet jan mallrat me te kerkuara ne internet. Eshte e ligjshme te ruhen shenimet personale te individit, e jo mijra kredenciale te huaja.

Ne raspordin me shkrim ne faqen e 5-te, pausi i pare, eshte thene se te tre te akzuarit kan bere tregti me kredenciale.

Kredencilaet e kredit kartelave jan perdore nga te tre te akzuarit, me te dhenat qe kan poseduar, mundesh me ble mall.

Ne baze te mesazheve qe ka gjetur nga te akzuarit jan zhvilluar biseda qe kan zhvillu te akzuarit me shitsit gjegjisht bletsit e ketyre kredencialeve. Ne baze te evidences qe ka gjetur ne provat e diskut, pagesa e tani te akzuarve eshte bere prej PAY Ball, Money Gram e tj.

Keto keqepedorime vrehen nga pronart e kredit kartelave, sepse ata jan ne Amerike, ndersa behet nje pagese ne Europe. I demtuar ne kete rast eshte pronaret e vertet te kredit kartelave.

Ng ate akzuarit asnje sistem kompjuterik ne Kosove nuk eshte prekur. Palet e demtuara qe jan prek nga te gjitha te akzuarit jan nga SHBA, Kanada, Angli e tj.

Ky (eksperti) konstaton se Liridon Isufi ka nderhy ne sistemet e tjera kompjuterike te shteteve qe i ceku.

Ne baze te shenimeve qe jan gjete ne harddisk dhe ne raportin e ekspertit, **qe te tre te akzuarit kan bere shitblerje ne internet dhe per habi ka has vetem ne shifra te vogla dhe dhjetra euro dhe rralle me qindar euro.** Keto pagesa jan bere nga kreditkartela te huaja. Eksperti ka pranuar qe ne faqen e 5-te pasusi i 2.2 ku flitet per L.I ka permend se jan gjetur mijra imella dhe po qe se do te ishin shkruar me emer dhe mbiemra, raporti do te kishte dal rreth 300 faqe. Ne permbajtje ne Harddisk jan ata emra.

Nga Kosova nuk ka pale te demtuar.

Tetdhjete mije shenime me emer dhe mbiemer jan gjetur ne follderin e L. Sh

Teknikisht ka mundsi qe kreditkartelat-shenimet nga keto kartela te huaja te futen ne sistemin kompjuterik, duke shkarkuar ndonje faqe apo virus. Ne follderin e L.Sh ka gjete miliona imella. Nga follderi qe eshte ne emer te L.Sh ka ardhur ne perfundim se pagesat jan bere nga shenimet qe jan marre nga follderi.

Edhe per Lavdimin e ka marre harddiskin, ka qen nje folder i ndare e cekur sakt ne raportin e tij (ekspertit) ne faqe 4-te.

Sipas ekspertit po te ishin skruar personat e demtuar ne kete rast, raporti do te ishte rreth 300 faqe.

Ketij eksperti gjykata ia fale besimin ne tersi, sepse ekspertizen e tij e ka bazuar ne te dhenat qe I ka nxjerre nga laptopet, kompjuteret e te pandehurve, CD-ve USB ve qe jan sekuestruar nga te pandehurit.

I akzuuari I parë L.I, vet ka pranuar shuma të caktuara të hollave qe prej vitit 2011 e deri me 4 gusht 2015, qe nuk e ka mohuar gjate marrjes ne pyetje ne séance gjyqsore, ne shuma te ndryshme, duke u arsyetuar se ka shitur programe-dizajna te ndryshëm, pastaj ka bërë mirëmbajtjen programeve në Kine, pastaj edhe familjaret e tij siq eshte M.I H. I dhe V. A kan pranuar te hlla nga dergues nga Kina, Rusia, SHBA , Kanda e tj. **Deshmitari I.I e ka pranuar se ka terhequr te holla ne Western Union 2 here, por se nuk i kujtohet shuma. Parat i ka terhequr ky vet, sepse parat kan qen ne emrin e tij. Paratë nuk kan qen te tijat por te L..., por se kan ardhur ne emrin e tij. Ato te holla I'a ka dhene menjehere L.... Nuk i kujtohet sakte por se L... i ka dhene dicka prej ketyre parave, pasi qe nenen e ka pas te smure.** Shuma e pergjithshme arrin ne **73.477.18 euro, qe vertetohet** ne baze te transaksioneve bankare dhe ne baze te nji raporti te ATK-se te dates 29.11.2017.

Keto shuma te te hollave jan derguar nga shtetas nga Kina, SHBA, Rusia e tj, gjate gjithë periudhes kohore qe akuzuahen, e te cilat jan rezultat I keqepedorimit te kreditkartelave te njerzve te pa njohur, duke bere pagesa me mjete te tyre, pa pelqimin e tyre.

Gjykata eshte e bindur, se të tre të akzuarit kan bashkpunuar gjat aktivitetit criminal, kjo shifet nga bisedat telefonike, ku ne një rast I akzuarit L.M me date 25.07.2015 I thot “ti kam pregaditur do shella”, që sipas deshmitarit V. P , Fjala Shell, do te thotë është një virus që infekton një kompjuter duke u mbeshtjelle rreth kodit. Pastaj nga vezhgimi I levizjeve te tyre nga ana e policiës, del se këta kan bashkpunuar dhe jan njohur ndermjet veti.

Gjate matjes dhe shqitpimit te denimeve, gjykata ka patur parasysh sjelljen e mire te te pandehurve ne gjykate, I jan pergjigjur gjithnji ftesave per gjykate, **ndersa si rrethana renduese** gjykata ka patur parasysh se kjo veper kryhet vetem me dashje direkte, me qellim perfitimi, eshte veper penale intelegjente, nuk munde ta kryj qdo person, numrin e madhe te personave te demtuar, demton rende imazhin e shtetit te Koosoves ne raport me shtete tjera, e sidomos me ato, qytetaret e te cilve jan demtuar, e ketu kemi numer te madhe te qytetarve qe u jan demtuar kreditkartelat bankare dhe rrezikshmerine e larte te ketyre veprave penale, ku jan demtuar pronat e njerzve te pa fajshem.

Ne kete aktivitet penale, gjykata te L.I e ka konsideruar si person kryesore, sepse I njejti ka pranuar shuma te caktuara te te hollave nga kjo nderhyrje ne sistemin kompjuterik, pastaj ka angazhuar edhe familjarte e tij, e keshtu duke perfituar ne menyre te kunderligjshme shumen prej 73.477.18 euro.

Gjykata eshte e bindur se me denimet e shqiptuara per te akzuarit, te njejtat do te ndikojn pozitivisht qe ne te ardhmen mos te kryejn vepra te tilla.

**Jan detyruar** te akzuarit L.I, L. Sh dhe L. M qe sejcili prej tyre, ne emer te paushallit gjyqsor te paguajn nga 200 (dyqind) euro, per viktimat e krimit nga 50 euro sejcili prej tyre, ndersa shpenzimet e procedures sipas llogarise perfundimtare.

**Te akzuarit L. I I** konfiskohen: një lllaptop HP 2000 ..., një kompjuter HP Compaq ..., Kompjuter LG ..., Laptop Lenova ... CD Princo, Iphone 6 ngjyre ari ..., Samsung ngjyre hiri .../2, Kartele Bankare E.P

RaiffaisenBank, Kartel Bankare L. I Payoneer, Laptop HP ..., Laptop Asus ..., Laptop Samsung ...

**Te akuzuarit L. M** I konfiskohen: CD te ndryshme pa mbishkrim, SD Karten, kartela bankare ....te cilat do te shkatrohen pas plotfuqishmeris se ketij aktgjykimi, sepse jan perdore per kryerjen e vepres penale qe ngarkohen te akuzuarit.

**Te akuzuarit L. I** I konfiskohen 2 banknota nga 100 euro, 16 banknota nga 50 euro, ne shume te pergjithshme prej 1.000,00 (njimije)Euro dhe te pandehurit **L.Sh I konfiskohet shuma e parave** prej 4.500,00 (katermijeesqind) euro, per shkak se nuk kan paraqitur prova qe te njejtat jan fituar ne menyre ligjore, te cilat pas plotfuqishmeris se ketij aktgjykimi do te derdhen ne Bugjetin e Republikes se Kosoves.

**Te akuzuarit L. Sh** i konfiskohen;  
Dy DVD,

Një USB-... me numër serik SF...,  
Dy USB- Verbotim ngjyrë e zezë,  
Një USB - Sony 16 GB - ngjyrë e bardhë,  
Një w USB - Sony 16 GB - ngjyrë e zezë  
Një USB - Adata c 906 ngjyrë e zezë,  
Një telefon Samsung SM...,  
Një telefon Samsung DUOS Sh...,  
Një telefon Iphone S4,  
Një laptop lenovo - Type ... - ..., Product ID:... 11. Një laptop lenovo - TYPE ... - 8 EI S/N R8-..., Product, ...,  
Një Adapter i hardiskit të jashtëm,  
Një tel Nokis sn. ...,  
Një tel.Soni Ericson ngjyrë hiri, te cilat do te asgjesohen pas plotfuqishmeris se ketij aktgjykimi.

**Te pandehurit L. I I kthehet vetura Audi** me targa ... me nr. identifikues ..., qelsat dhe gjithe dokumentacioni percjells I vetures, sepse nuk ka prova qe te njejtat e ka perdore ne kryerjen e vperes penale, per te cilen eshte shpallur fajtor.

Pas vertetimit te gjendjes faktike, gjykata ka ndryshuar dispozitivin I. te aktakuzes, ashtu qe ne vend te fjaleve nga viti 2007, gjykata ka futur fjalet nga viti 2011, per shkak se sipas Ekspertizes kompjuterike te ekspertit B. R,

Në bazë të aktiviteteve të zhvilluara në internet, shih dëshmitë IEF (Internet Evidence Finder) nga hetuesia, intervali kohor është nga viti 2011 deri te pjesa e parë e vitit 2015.

Me kete eshte eleminuar pretendimi I mbrojtis, te te Akuzuarit L. I se klienti I tij ne vitin 2007 ka qen I mitur, pastaj kundershimi I te njejtit mbrojtës se Ligji per parandalimin dhe luftimin e krimit Kibernetik nuk munde te aplikohet, sepse ka hyre ne fuqi ne vitin 2010, sepse sipas ekspertit te kibernetikes B. R aktiviteti I Liridon Isufit ne Internet lidhur me kete veper eshte nga viti 2011 e deri me 2015.

Pastaj ne rreshtin e gjashte te po ketij dispozitivi, ka hequr fjalen e **krijuar**, per shkak se eksperti B.R ne deklaraten e tij te dhene ne gjykate ka pohuar, se **te akuzuarit nuk e kan krijuar kete shitore per shitblerje**, por kan qen nje nder shume perdoruesit e saje.

Provat te cilat nuk jan permende ne vertetimin e gjendjes faktike, jan inkorporu ne ekspertizen kompjuterike te kryer nga eksperti B.R

Keshtu u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**  
**Me dt, 15.12.2020**

**Sek. Jurdike,**  
**Fikrete Destani**

**Kryetari i trupit:**  
**Naser Maliqi**

**KSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi, palët e paknaqura mundë të ushtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:055119  
Datë: 21.12.2020  
Numri i dokumentit: 01359162